

VENDIM
Nr.166, datë 19.3.2026

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “ZGJERIMI I VARREZAVE PUBLIKE NË FSHATRAT PODGORIE, SOVJAN, POJAN, ZËMBLAK DHE VLOÇISHT”, BASHKIA MALIQ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Zgjerimi i varrezave publike në fshatrat Podgorie, Sovjan, Pojan, Zëmbllak dhe Vloçisht”, Bashkia Maliq.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Maliq.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “arë”, me një vlerë të përgjithshme prej 3 545 124 (tre milionë e pesëqind e dyzet e pesë mijë e njëqind e njëzet e katër) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 3 545 124 (tre milionë e pesëqind e dyzet e pesë mijë e njëqind e njëzet e katër) lekësh, përballohet nga buxheti i Bashkisë Maliq.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Bashkisë Maliq.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Maliq.

8. Bashkia Maliq kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Maliq.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Korçë–Devoll–Kolonjë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Maliq për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Maliq për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Maliq, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Korçë–Devoll–Kolonjë, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Korçë për zbatimin e këtij vendimi.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE TË TË CILËVE PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTI "ZGJERIMI I VARREZAVE PUBLIKE NË FSHATRA PODGORIE, SOVJAN, POJAN, ZËMBLAK DHE VLOÇISHT", TË BASHKISË MALIQI														
Nr.	TË DHËNAT E PRONËSISË			TË DHËNAT KADASTRALE (SIPAS KARTELËS SË PASURISË)					VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM, SIPAS LLOJIT TË PASURISË				SHËNIME	
	Emri	Aftësia	Mbiemri	Fshati ose qyteti	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. Totale (m²)	Arë (m²)	Arë				VLERA TOTALE (lekë)
										Sipërfaqja (m²)	Cnimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)		
1	Esat	Bedri	Hadri	Podgorie	3010	99/6	Arë	2083	2083	2083	100	208.300	208.300,0	
2	Tahir	Hysen	Bezati	Podgorie	3010	99/7	Arë	2074	2074	2074	100	207.400	207.400,0	
3	Hysen	Tahir	Bezati	Podgorie	3010	99/8	Arë	2501	2501	2501	100	250.100	250.100,0	
4	Nesti	Dhori	Kozmallari	Sovjan	3496	1635/1	Arë	2475	2475	2475	100	247.500	247.500,0	
5	Niko	Dhori	Kozmallari	Sovjan	3496	1635/2	Arë	3182	3182	3182	100	318.200	318.200,0	
6	Jovan	Numi	Kozmallari	Sovjan	3496	1635/3	Arë	3286	3286	3286	100	328.600	328.600,0	
7	Higmet	Emin	Mullalli	Zëmbllak	3903	141/3	Arë	1685	1685	1685	100	168.500	168.500,0	
8	Erion	Ditron	Mullalli	Zëmbllak	3903	141/4	Arë	560	560	560	100	56.000	56.000,0	
9	Shkelzen	Ibrahim	Mullalli	Zëmbllak	3903	141/6	Arë	1690	1690	1690	100	169.000	169.000,0	
10	Nefail	Rushan	Mullalli	Zëmbllak	3903	141/7	Arë	1055	1055	1055	100	105.500	105.500,0	
11	Hekuran	Xhezar	Mullalli	Zëmbllak	3903	141/8	Arë	1210	1210	1210	100	121.000	121.000,0	
12	Edison	Osman	Mullalli	Zëmbllak	3903	141/31	Arë	165	165	165	100	16.500	16.500,0	
13	Ardian	Osman	Mullalli	Zëmbllak	3903	141/32	Arë	495	495	495	100	49.500	49.500,0	
			Nestan	Mullalli										
14	Xhevahir	Dalip	Xhihani	Pojan	3014	92/29	Arë	1357	1357	1357	248	336.536	336.536,0	
15	Xhchel	Sali	Xhihani	Pojan	3014	92/30	Arë	1856	1856	1856	248	460.288	460.288,0	
16	Suat	Mvrteza	Xhihani	Pojan	3014	92/31	Arë	2025	2025	2025	248	502.200	502.200,0	
VLERA TOTALE													3.545.124	